




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA-KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-111/01-0008527/26
Data.
Data. 05-03-2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, duke u bazuar në nenin 78 paragrafi 2, nenin 80, nenin 81 dhe nenin 82 paragrafi 1 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, në nenin 8 dhe nenin 13 të Rregullores (QRK) nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, në nenin 20 dhe nenin 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr.04/L-032 si dhe në nenin 5, pika d), të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, NJMBNJ shpall:

KONKURS PËR PRANIM

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

Pozita: Drejtor i shkollës dhe zëvendësdrejtor

Institucioni: Komuna e Skenderajt

Njësia: Drejtoria për Arsim

Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik

Afati për aplikim: nga data 05.03.2026 deri më datën 04.04.2026

Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar 4 (katër) vite

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë për drejtor:

- Përgatitjen e Planit Vjetor, Planit Zhvillimor të Institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim(SMIA) dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimit dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë të institucionit edukativo-arsimor si dhe mekanizmave tjerë të institucionit që kanë rol në vlerësimin e performancës së institucionit dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunimin me Këshillin Drejtues të institucionit edukativo-arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimtarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor;
- Raporton së paku dy herë në vit para KDSH-së;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo-arsimor, duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH);

- Çështjet e tjera që rregullohen përmes Ligjit për arsimin parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASH dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë për zëvendës drejtor:

- Zëvendës drejtori i IEAAP ka përgjegjësi të mbështetë dhe të ndihmojë punën e drejtor-it/es për të siguruar administrimin dhe mbarëvajtjen e punës së institucionit shkollor, ai/ajo ka për detyrë:
- Të përkujdeset dhe të përcjellë mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe të ndihmojë në krijimin e klimës pozitive në institucionin shkollor;
- Të monitorojë dhe mentorojë mësimdhënësit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- Të përpunojë statistikën e suksesit të nxënësve dhe të dhënat e tjera në periudha të caktuara;
- Të përgatisë raport periodik për mbarëvajtjen e punës së institucionit shkollor.
- Të kontrollojë ditaret e klasës së paku njëherë në një periudhë mësimore dhe të udhëzojë mësimdhënësit për mbajtjen e shënimeve në mënyrën e duhur;
- Të ndihmojë dhe të përkrahë mekanizmat e institucionit shkollor për menaxhimin e cilësisë së performancës së institucionit;
- Të zëvendësojë mësimdhënësit në rastet kur mungojnë;
- Të pranojë, të kontrollojë dhe të sistemojë përgatitjen e planeve mësimore të mësimdhënësve;
- Ta zëvendësojë dhe ta përfaqësojë drejtorin e institucionit shkollor sipas nevojës;
- Të kryejë detyra të tjera të caktuara nga drejtori/eshja e institucionit shkollor, në pajtim me ligjin.

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojnë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm dhe normativit për arsim profesional në fuqi;
- Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimi 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Master arsimor (kualifikimi prej 300 ECTS, 5 vite të shkollimit universitar);
- Bachelor katërvjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS, 4 vite të shkollimit universitar).
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve,
- Të kenë të përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të ofruar nga një institucion publik i aprovuar nga MASHTI
- Të ketë të paktën pesë (5) vite përvojë pune si mësimdhënës/e në IEAA-AP.
- Të kalë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi

Të posedojnë këto dokumente:

- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës (secili konkurrues dorëzon **kopjen e noterizuar të diplomës Bachelor/Master**).
 - Në arsimin parafilior, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë (gjimnaze) duhet të jetë profili arsimor në bazë të normativit profesional për arsimin e përgjithshëm;
 - Për shkollat profesionale, kandidati/ja duhet të jetë i profilit përkatës për institucionin edukativo-arsimo ku konkurren, në bazë të normativit për arsimin profesional.
- Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të ofruar nga një institucion publik i aprovuar nga MASHTI.
- Nëse kandidati/ja ka përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, nuk obligohet të dorëzojë dëshmi/certifikatën e trajnimit për udhëheqje në arsim
- Kopjen e dokumentit të identitetit (ID)
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor, me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore, të lëshuar në gjashtë muajt e fundit.
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Vërtetim për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor;
- Deklaratë në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qene në asnjë funksion udhëheqës politik në strukturat e parive politike;
- Portfolion profesional me dëshmi sipas udhëzimeve në formularet e kësaj Rregulloreje;

Portfolio profesionale duhet të përmbajë:

- Biografinë e shkurtër të kandidatit.
- **Konceptin e Planit Zhvillimor** të institucionit edukativo-arsimor, bazuar në pesë fushat e cilësisë së performancës së shkollës (5-10 faqe).
- **Kopjet e noterizuara të diplomave (Master dhe Bachelor)**
- Certifikatat që dëshmojnë përfundimin e programeve të zhvillimit profesional në fushën e administrimit, menaxhimit dhe udhëheqjes, si dhe dëshmi tjera që elaborojnë përfundimin dhe realizimin e pjesëve të programit dhe demonstrojnë shkathtësitë e fituara.
- Certifikatat që dëshmojnë përfundimin e suksesshëm të programeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve si dëshmi tjera rreth realizimit të atyre programeve.
- Letër motivuese për pozitën që aplikon.
- Dëshmi për aktivitetet tjera në proceset e zhvillimit të arsimit (zhvillimi i kurrikulave, udhëheqja e programeve të zhvillimit profesional, pjesëmarrja dhe kontributi në konferenca, etj).
- Dëshmi nga përvoja paraprake në menaxhim (shembuj të projekteve, shembuj të shkrimeve nga fusha e menaxhimit, shembuj të planeve për zhvillimin e institucionit edukativo-arsimor që janë zhvilluar dhe/apo implementuar me udhëheqjen apo kontributin tuaj konkret).
- Dëshmi nga përvoja paraprake në mësimdhënie (shembuj të planeve të mësimi, shembuj të projekteve, kopje të punimeve, mirënjohje, etj).
- Letër-referencë me përmbajtje dëshmuuese për punën dhe angazhimet paraprake nga një institucion publik-kredibil, drejtpërdrejtë e lidhur me punën e kandidatit dhe për konkursin përkatës *(si Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DKA, këshilli drejtues i institucionit edukativo-arsimor, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë dhe individë me të cilët ka punuar ngushtë në programe dhe projekte të ndryshme për arsim).*

Pozitat aktualisht të lira:

Nr.	Titulli i pozitës	Koeficienti	Vendi i punës
1	Drejtorë/i e/i Shkollës Filllore dhe të Mesme të Ulët	7.2 - E14	ShFMU Ahmet Delia - Skenderaj
2	Drejtorë/i e/i Shkollës Filllore dhe të Mesme të Ulët	7.2 - E14	ShFMU Skender Skenderi - Vajnikë
3	Drejtorë/i e/i Shkollës Filllore dhe të Mesme të Ulët	7.2 - E14	ShFMU Azem Bejta - Pekaz i Epërm
4	Drejtorë/i e/i Shkollës Filllore dhe të Mesme të Ulët	7.2 - E14	ShFMU Elena Gjika - Makenal
5	Drejtorë/i e/i Shkollës Filllore dhe të Mesme të Ulët	7.2 - E14	ShFMU Halit Geci - Llaushë
6	Drejtorë/i e/i Shkollës Filllore dhe të Mesme të Ulët	7.2 - E14	ShFMU Ismet Rrahmani - Aqarevë
7	Drejtorë/i e/i Shkollës Filllore dhe të Mesme të Ulët	7.2 - E14	ShFMU Kuvendi i Drenicës - Abri e Poshtme
8	Drejtorë/i e/i Shkollës Filllore dhe të Mesme të Ulët	7.2 - E14	ShMU Rifat Mëziu - Skenderaj
9	ZëvendësDrejtorë/i e/i Shkollës Filllore dhe të Mesme të Ulët	7.0 - E15	ShF " Shaban Jashari " - Skenderaj
10	Drejtorë/i e/i Shkollës së Mesme të Lartë	7.3 - E13	IAAP Anton Çetta - Skenderaj
11	ZëvendësDrejtorë/i e/i Shkollës Mesme të Lartë	7.2 - E14	Gjimnazi "Hamëz Jashari" Skenderaj
12	Drejtorë/i e/i Institucionit Parashkollor	7.0 - E 15	IP - Skenderaj

Mënyra e aplikimit:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën Pritëse, QSHQ Arkivë në Administratën e Komunës së Skenderajt dhe duhet të dorëzohen të plotësuara nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

a. Testi më shkrim

b. Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios.

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:

Përmes ueb faqes së Komunës së Skenderajt dhe portalit për rekrutim elektronik

(<https://konkursi.rks-gov.net>).

Sqarime shtesë:

a. Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

b. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

c. Kandidatet kanë të drejtë të aplikojë në një e më shumë shkolla. Në raste të tilla përgatit dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional siç specifikohet me legjislacionin në fuqi.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

